

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika Boom<sup>®</sup>-521 FoamFix

SHKUMË POLIURETANI ME THARJE TË SHPEJTË, ZGJERIM SHUMË TË PAKËT QË APLIKOHET ME PISTOLETË PËR NGJITJEN E PANELEVE IZOLUESE, PLLAKA GIPSI DHE MONTIME NË MOBILIERI.

### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika Boom<sup>®</sup>-521 FoamFix është shkumë poliuretani me 1 përbërës dhe me zgjerim shumë të ulët.

### PËRDORIMET

Sika Boom<sup>®</sup>-521 FoamFix është gati për përdorim për pllakat e gipsit dhe materialet izoluese të mëposhtme:

- Panele XPS
- Panele EPS - Styrofoam
- Panele me fibra druri
- Panele tape
- Panele bituminoze
- Panele PIR/PUR

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- 1 kanaçe është e mjaftueshme për një sipërfaqe ~ 14 m<sup>2</sup>
- Ngjitje e mirë mbi beton, nënshtresa bituminoze, dru, tulla, suva, metal dhe PVC
- Tharje e shpejtë
- Rezistencë e mirë e ndërkapjes në tërheqje
- Përdoret për aplikime të brendshme dhe të jashtme
- I përshtatshëm për aplikime vertikale dhe horizontale
- Pa HFC

### MIRATIME / STANDARDE

Kategoria E për klasifikimin në zjarr (sipas EN 13501-1 dhe B2 DIN 4102)

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Poliuretan me 1 përbërës, thahet me lagështinë	
<b>Ambalazhi</b>	kanaçe 750 ml, 900 g (12 copë/ kuti)	
<b>Ngjyra</b>	Rozë e lehtë	
<b>Jetëgjatësia</b>	12 muaj nga data e prodhimit, nëse magazinohet saktë	
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Të ruhet në ambalazhin origjinal dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor në temperatura midis +10°C dhe +23°C. Kanaçja duhet të ruhet në pozicion vertikal! Një kanaçe e hapur duhet të përdoret brenda pothuajse 4 javësh.	
<b>Dendësia</b>	21±3 kg/m <sup>3</sup>	
<b>Rezistenca ndaj ngjeshjes</b>	~ 0.03 N/mm <sup>2</sup> (në 23°C / 50% lagështi relative) me 10% defomim	(DIN 53 421)
<b>Rezistenca ndaj tërheqjes</b>	~ 7.6 N/cm <sup>2</sup> (në 23°C / 50% lagështi relative)	(DIN 53 430)
<b>Zgjatimi deri në thyerje</b>	~ 31% (në 23°C / 50% lagështi relative)	(DIN 53 430)
<b>Rezistenca ndaj prerjes</b>	~ 0.04 N/mm <sup>2</sup> (në 23°C / 50% lagështi relative)	(DIN 53 427)

<b>Qëndrueshmëria e përmasave</b>	~ ± 5% (në 23°C / 50% lagështi relative)
<b>Përthithja e ujit</b>	< 1% vëllim (sipërfaqe e prerë)
<b>Përçueshmëria termike</b>	~ 0.036 W/mK (në 23°C / 50% lagështi relative) (DIN 52 612)
<b>Temperatura e funksionimit</b>	-40°C deri në +100°C
<b>Konsumimi</b>	Konsumimi mund të rregullohet duke adaptuar presionin e valvulës tek pistoletë Sika® Dispenser. Kanaçe 750 ml (900 g) me rendiment të lartë: deri në 55 litra në varësi të lagështisë dhe temperaturës. ~ 14 m <sup>2</sup> , fiksion i paneleve Styrofoam ~ 40 m <sup>2</sup> , prerje tërthore e pikës 30x30mm
<b>Temperatura e mjedisit</b>	Temperatura e duhur e përdorimit: +20°C Temperaturat e lejueshme të përdorimit: +0°C min. / +30°C max.
<b>Lagështia relative e ajrit</b>	Midis 30% dhe 95%
<b>Temperatura e nënshtresës</b>	+5°C min. / +30°C max.
<b>Koha e maturimit</b>	Një shtresë 20 mm e shkumës së zgjeruar mund të pritët pas 20-45 minutash (në 23°C / 50% lagështi relative) Tharje e plotë pas 12 orësh (në 23°C / 50% lagështi relative)
<b>Koha e tharjes së sipërfaqes</b>	~ 6±2 minuta (në 23°C / 50% lagështi relative)

## UDHËZIME APLIKIMI

- Temperatura e kanaçes duhet të jetë +5°C min. dhe +30°C max.
- Për aplikimin e saktë të produktit temperatura e kanaçes duhet të jetë +20°C.
- Kanaça duhet të mbrohet nga dielli i drejtpërdrejtë dhe temperaturat mbi +50°C (rrezik shpërthimi).
- Të mos përdoret mbi PE, PP, Teflon, silikon apo disarman të tjerë.
- Shkuma nuk ka rezistencë ndaj dritës UV.
- Lexoni rekomandimet teknike dhe rekomandimet e sigurisë të printuara mbi kanaçe.

## PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e pastër dhe e thatë, e njëtrajtshme, pa vaj dhe graso, pluhur dhe grimca të lira ose të shpërbëra.

Lagni paraprakisht nënshtresën me ujë të pastër, kjo gjë siguron se shkuma thahet saktë dhe parandalon gjithashtu zgjerimin e mëvonshëm të saj.

## METODA E APLIKIMIT / MJETET

Temperatura e nënshtresës dhe aplikimit duhet të jetë +0°C deri në +30°C. Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e fortë, e pastër, pa pluhur dhe graso. Tundeni mirë për rreth 20 sekonda përpara se të përdorni Sika Boom®-521 FoamFix dhe përsërisni pas ndërprerjeve të gjata. Ktheni kanaçen mbrapsht dhe mbërthejeni tek valvula e pistoletës Sika® Dispenser.

Spërkasni të paktën 3 pika mbi panelin e izolimit ose direkt mbi nënshtresë. Sasia e shkumës mund të rregullohet me pistoletën Sika® Dispenser nëpërmjet këmbëzës dhe mbërthimit në pjesën e pasme të pistoletës së aplikimit. Gjatë spërkatjes, kanaça duhet të qëndrojë në pozicion vertikal. Pas aplikimit të Sika Boom®-521 FoamFix mbi panel ose nënshtresë, prisni për ~ 4-6 minuta përpara se të ngjeshni panelin izolues

mbi nënshtresë (shkuma ka nevojë për pak kohë që të hyjë në reaksion). Koha e tharjes së shkumës për fiksion të shpejtë varet nga temperatura dhe lagështia. Prandaj dhe rekomandohet testimi i kohës specifike të tharjes përpara aplikimit përfundimtar. Nëse nevojitet mbushni hapësirat midis skajeve të paneleve duke përdorur Sika Boom®-521 FoamFix. Pas tharjes, shkuma e tepruar mund të pritët me thikë ose fërkojeni me një limë.

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pistoletë Sika® Dispenser duhet të pastrohet me Sika Boom®-Cleaner ose aceton menjëherë pas përdorimit. Shkuma e tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika Boom®-521 FoamFix

Maj 2019, Botimi 01.01

02051406000000094

SikaBoom-521FoamFix-sq-AL-(05-2019)-1-1.pdf